

Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit

2021-2024



PROGRAMI I STUDIMEVE “BACHELOR” PËR SIGURINË DHE HETIMIN

Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit në Akademinë e Sigurisë, zhvillon dhe transmeton dijet me anën e mësimdhënies e të kërkimit shkencor, në fushën e sigurisë dhe hetimit të krimit, për përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të Policisë së Shtetit dhe të strukturave të tjera ligjzbatuese.



AKADEMIA E SIGURISË
FAKULTETI I SIGURISË DHE HETIMIT

Nr 52 Prot.
Vendim i Senatit

Tiranë më 08 . 10 .2021

PROGRAMI I STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË
PËR SIGURINË DHE HETIMIN

Dekani

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Miratuar me Vendim nr. 52, dt. 8.10.2021, të Senatit të AS-së,
“Për miratimin e ndryshimeve të kryera në ripunimin e programit mësimor ‘Bachelor’ për
“Sigurinë dhe Hetimin”, 2021-2024”

Tiranë, 2021

Pjesa I

Argumentimi i çeljes së

“PROGRAMIT TË STUDIMEVE PËR SIGURINË DHE HETIMIN”

Struktura, objektivat dhe profili i diplomës

1. Përshkrim përmbledhës i “Programit të studimeve”

- Lloji i studimeve: Studime të Larta për Sigurinë dhe Hetimin.
- Niveli i studimeve: Cikli i parë i studimeve universitare
Emërtimi akademik: Studime të ciklit “Bachelor” për “Sigurinë dhe Hetimin”
- Kohëzgjatja e studimeve: 3 (tre) vite akademike.
- Forma e studimeve: Me kohë të plotë.
- Numri i krediteve ECTS: 180 kredite ECTS .
- Numri i krediteve në një vit: 60 kredite ECTS në një vit akademik.
- Profili profesional i pritshëm: “Specialist për Sigurinë dhe Hetimin”.
- Objektivi i plan-programit: Të përgatisë specialistë për strukturat në Policinë e Shtetit, të aftë për të shërbyer në funksionet operuese e menaxheriale në shërbimet policore për “Sigurinë dhe Hetimin”;
- Struktura e programit: Ndarja e 180 krediteve ECTS, sipas kategorizimit të lëndëve përafërsisht është:
 - Lëndë bazë, 32 kredite;
 - Lëndë karakterizuese, 93 kredite;
 - Lëndë ndërdisiplinore/integruese dhe me zgjedhje, 26 kredite;
 - Lëndë plotësuese, 23 kredite;
 - Detyrime përmbyllëse, 6 kredite.Kushtet e pranimit: Pranimi në Programin studimeve për sigurinë dhe hetimin:
 - të ketë përfunduar arsimin e mesëm me mesataren jo më të ulët se përcaktimi në VKM-në;
 - të jetë certifikuar për përfundimin e “Kolegjit të Lartë Profesional në Akademinë e Sigurisë”;
 - të ketë vjetërsi në strukturat policore sipas përcaktimeve në Rregulloren e Policisë së Shtetit;
 - të ketë marrë pjesë dhe të jetë shpallur fitues në procesin e konkurrimit për pranim në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit.
- Njësia akademike zbatuese: Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit
- Institucioni i Arsimit të Lartë: Akademia e Sigurisë,
Rruga e Elbasanit, kilometri 3 – Sauk/Tiranë

2. Referencat ligjore dhe përgjegjësitë institucionale

Programi i studimeve “Bachelor” për sigurinë dhe hetimin, që paraqitet për shqyrtim e miratim është hartuar në ushtrim të përgjegjësiave e të drejtave që burojnë nga legjislacioni për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, nga ligji për Policinë e Shtetit dhe strukturave të tjera ligjzbatuese në zbatim të kërkesave të akteve që rregullojnë veprimtarinë e institucionit të Akademisë së Sigurisë.

Akademia e Sigurisë¹ është institucion i arsimit të lartë policor ku në përbërje të saj ka Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit si institucion arsimor përgjegjës në nivelin e parë “Bachelor”, për përgatitjen dhe formimin profesional të specialisteve të lartë të sigurisë, hetimit dhe kualifikimin e vazhdueshëm të punonjësve të tyre.

Programi i studimeve “Bachelor” për “Sigurinë dhe Hetimin”, që ju vihet në dispozicion për miratim është ripunim i programit të miratuar i cili është hartuar në zbatim të kërkesave të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, Ligjin për Policinë e Shtetit, legjislacioni i institucioneve të tjera ligjzbatuese, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në zbatim të tyre, pasi ka kaluar një tre vjeçar dhe në këtë program janë bërë ndryshimet respektive në përputhje me mendimet e dhëna nga departamentet si dhe nga anketimet e organizuara me studentët që e kanë përfunduar programin.

Përveç referencave ligjore, hartimi i Programit dhe “Planit mësimor” është mbështetur edhe në “Programin e zhvillimit strategjik të Policisë së Shtetit dhe Akademisë së Sigurisë”, në Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të saj, si dhe më diskutimet e propozimet e bëra nga stafi akademik i institucionit. Po ashtu, gjatë procesit të hartimit u mbajtën në konsideratë eksperiencat dhe standardet e shkollave policore perëndimore dhe ato të rajonit.

Programi dhe plani mësimor e vënë theksin në formimin shoqëror e juridik, respektimin e lirive e të drejtave të njeriut, duke synuar formimi e një studenti me nivel të lartë arsimor në fushat profesionale dhe social-juridike.

Në përputhje me statusin ligjor dhe misionin e Akademisë është hartuar edhe ky program i studimeve “Bachelor” për “Sigurinë dhe Hetimin” si dhe plani mësimor për të përgatitur specialistë të lartë policie që do të shërbejnë në nivelin e nënkomisarit në të gjitha funksionet dhe postet që mbulohen nga kjo gradë.

3. Nevojat e ripunimit të Programit

Ripunimi i “Programit të studimeve të ciklit të parë “Bachelor” për Sigurinë dhe Hetimin synon të zgjidhë disa kërkesa të policisë dhe strukturave të tjera ligjzbatuese duke reflektuar në lidhje me evolucionet e viteve të fundit:

- Për formimin e specialistëve të lartë të policisë në fushën e Sigurisë dhe Hetimit, të aftë për të punuar në të gjitha strukturat, shërbimet dhe funksionet policore brenda nivelit të gradës nënkomisar, me kulturë e dije të nivelit universitar, me standarde të larta etike profesionale dhe njohës të mirë të ligjit, të misionit dhe përgjegjësiave institucionale të

¹Veprimtaria e Akademisë së Sigurisë sot mbështetet në Legjislacionin Arsimor, kryesisht në ligjin nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” (kreu VII, neni 37 e 38); VKM nr. 185, datë 25. 02. 2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”; Urdhri Nr. 180 datë 15.04.2016, të ministrisë së Arsimit dhe Sportit për “Riorganizimin institucional të Akademisë së Sigurisë; Urdhri Nr. 491 datë 05.09. 2016 për “Disa ndryshime në Urdhri nr. 294 datë 05.06.2015 të Ministrisë së Punëve të Brendshme “Për miratimin e Strukturës organike të Akademisë së Sigurisë” të ndryshuar statutin dhe rregulloret e brendshme të saja.

policisë, por dhe me aftësi praktike e shprehi në menaxhimin e situatave të sigurisë publike dhe të hetimit të krimit.

- Për të eliminuar mangësitë dhe pasojat negative në fushën e arsimimit, dhe përmirësimin sa më parë të nivelit profesional të punonjësve të policisë dhe strukturave të tjera ligjzbatuese; nivel i cili aktualisht me dinamikën e kriminalitetit ka pësuar përmirësime të vazhdueshme nga viti në vit dhe me përfundimin e një cikli të plotë Fakulteti dhe departamentet bënë rifreskimin e tij me ndryshimet e shumta në legjislacionin shqiptar si dhe në eliminimin dhe përmirësimin e disa mangësive të vërejtura gjatë këtyre tre vjetëve.
- Përbushjen profesionalisht gjithnjë e më mirë të detyrimeve për bashkëpunimin policor ndërkombëtar dhe me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, veçanërisht në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikeve kriminale, duke njohur natyrën transnacionale dhe karakterin global të luftës ndaj tij dhe vlerësuar se, bashkëpunimi ndërkombëtar nuk është një kërkese e thjeshtë, por nevojë jetike për shtetin dhe shoqërinë.

4. Programi dhe grupet e interesit

Departamentet e Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, u përfshinë në një veprimtari të gjerë e intensive, në përmirësimin e këtij programi duke bashkëpunuar me studentët që e kanë përfunduar si dhe me drejtuesit e tyre duke marrë dhe ndryshuar të gjitha vërejtjet si dhe duke përmirësuar atë në përputhje me standardet vendeve të BE. Veçanërisht, i kushtuan vëmendje e kujdes të posaçëm kontakteve me grupet e interesit dhe faktorët institucionalë për marrjen e mendimeve, vlerësimeve, opinioneve dhe sugjerimeve të tyre, për disa nga çështjet më themelore, si:

- drejtimit ku duhet përqendruar për organizimin e planeve mësimore;
- si mund të ngushtojmë hapësirat midis teorisë dhe praktikës;
- në cilat aspekte mendohet se duhet përmirësuar profili i specialistit të sigurisë dhe hetimit;
- nëse është e mjaftueshme përgatitja e tyre për t'u përballur me tendencat e zhvillimeve në fushën e kriminalitetit, rendit dhe sigurisë publike ;
- eliminimin e përsëritjeve si dhe në aspekte të tjera drejtshkrimore;

Programi mësimor në vetvete ka një bosht lëndor ku shkrihen informacione edukative, kulturore, afrohen dije, aftësi dhe kompetenca profesionale që duhet të ketë një specialist i sigurisë dhe hetimit;

Ndër veprimtaritë konsultative për ripunimin e “Programit të studimit “Bachelor” për “Siguri dhe Hetim”, përmendim:

- Konsulta me personelin akademik dhe administrativ të vetë Akademisë së Sigurisë në të gjitha nivelet;
- Kontaktet dhe shkëmbimi i ideve dhe mendimeve me specialistët, pedagogët dhe drejtuesit e Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Drejtësisë në Tiranë;
- Kontakt dhe shkëmbim idesh me strukturat e prokurorisë në rrethe dhe qendër për të evidentuar mangësitë që reflektojnë oficerët e policisë gjyqësore në formimin e tyre profesional;

- Bashkëbisedim dhe shkëmbim i mendimeve me specialistët dhe drejtues të strukturave përfituese në Policinë e Shtetit” dhe strukturat e tjera ligjzbatuese;
- Dërgimi zyrtarisht i projekt programit, strukturave të tjera në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, dhe në strukturat e tjera ligjzbatuese, për të marrë mendimin e specialistëve të strukturave operuese lidhur me drejtimit ku duhet të përqendrohet më mirë vëmendja e strukturave akademike;
- Organizimi i ballafaqimeve dhe konsultave me specialistët e Drejtorisë së Kufirit & Migracionit dhe Rendit e Sigurisë Publike dhe administrimi e pasqyrimi i vërejtjeve dhe sugjerimeve të tyre për programin;

5. Parimet dhe kërkesat e Programit

Parimet dhe kërkesat themelore të Programit “Bachelor” për Siguri dhe Hetimin, burojnë nga kuadri ligjor e normativ i procesit akademik si dhe nga misioni, detyrat e përgjegjësitë institucionale të Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera ligjzbatuese.

Është e rëndësishme të theksohet se i gjithë procesi i ripunimit të Programit të studimit, i dokumenteve dhe akteve zyrtare që e shoqërojnë atë, mban parasysh dhe respekton parimet universale të zhvillimit të arsimit dhe kërkimit shkencor në institucionet akademike publike. Për rrjedhojë, si pjesë e Arsimit të Lartë Publik, Arsimi i Lartë Policor:

- ofron “mundësi të barabarta, jo vetëm konkurrimi, por edhe shkollimi”, pa përjashtuar askënd që plotëson kriteret²;
- mundëson që programet e të gjitha niveleve të studimit të sigurojnë “integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor”;
- siguron kushtet që “studentët të mësohen nga staf i zgjedhur akademik me tituj e grada shkencore, me performancë të lartë në mësimdhënie, në kërkim shkencor dhe në inovacion”;
- ofron kushte e mundësi që “stafi dhe studentët të gëzojnë liri të plota akademike dhe pavarësi organizative në aktivitetin mësimdhënës, në kërkimin shkencor dhe në zgjedhjen dhe promovimin akademik”.

6. Përfaqja e “Programit të studimit” me misionin e Akademisë

Studimet “Bachelor” për Siguri dhe Hetim, organizohen dhe realizohen në Akademinë e Sigurisë³, nën përgjegjësinë e Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, departamenteve e strukturave përbërëse të tij. Autorizimet konkrete ligjore për ofrimin dhe organizimin e këtij programi jepen me anë të VKM-së⁴, si dhe akteve të tjera në funksion të tij.⁵

Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, si pjesë përbërëse e Akademisë së Sigurisë, ka për mision:

² të ketë përfunduar arsimin e mesëm me mesataren jo më të ulët se “nota 6”; të jetë certifikuar për përfundimin e kursit të “Kolegjit të Lartë Profesional në Akademinë e Sigurisë”; të ketë jo më pak se dy vjet në strukturat apo institucionet e Policisë së Shtetit; të ketë marrë pjesë dhe të jetë shpallur fitues në procesin e konkurrimit për pranim në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit.

³ *Akademia e Sigurisë ka për mision:* “Formimi, kualifikimi dhe specializimi i punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit, i strukturave të tjera ligj zbatuese në Shqipëri si dhe i personave fizike dhe juridike në fushën e rendit e të sigurisë publike”.

⁴ V. K. M nr. 185, datë 25.02.2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”.

⁵ Urdhri Nr. 180 datë 15.04.2016, të ministrisë së Arsimit dhe Sportit për “Riorganizimin institucional të Akademisë së Sigurisë; Urdhri Nr. 491 datë 05.09.2016 për “Disa ndryshime në Urdhri nr. 294 datë 05.06.2015 të Ministrisë së Punëve të Brendshme “Për miratimin e Strukturës organike të Akademisë së Sigurisë” të ndryshuar.

“Formimi, kualifikimi dhe specializimi i punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit, i strukturave të tjera ligj zbatuese në Shqipëri si dhe i personave fizike dhe juridike në fushën e rendit e të sigurisë publike”.

Programi i studimeve ka për bazë:

- planin mësimor,
- programet lëndore “*syllabus*”-et e lëndëve dhe
- rregulloren e “Programit të studimit për Siguri dhe Hetim”.

Nëpërmjet tyre synohet zhvillimi i procesit akademik (mësimdhënies e mësim nxënies), kompetencave që do të përftohen dhe profilit të pritshëm të specialistit.

7. Objektivat e “Programit të studimit” dhe rezultatet e pritshme

Mbështetur në nevojat që ka policia dhe strukturat e tjera ligjzbatuese për kualitete profesionale, për investigimin, hetimin sigurinë dhe goditjen e formave dhe metodave të krimit, disa objektiva të synuar me zhvillimin e këtij programi janë:

- Plotësimi i nevojave që ka Policia e Shtetit dhe strukturat e tjera ligjzbatuese për specialistë të aftë profesionalisht dhe nivel të lartë kulturor në përputhje me zhvillimet social ekonomike të vendit.
- Rritja e kapaciteteve të formimit policor, duke u bazuar dhe në përvojat e arsimore të vendit tonë dhe shkollave më të mira perëndimore.
- Realizimin e studimeve universitare bashkëkohore, të cilat marrin në konsideratë kërkesat në rritje të komunitetit, për punonjës profesionistë.
- Parashikimi në rregulloren e programit dhe në planin mësimor të studimeve i njohjes dhe transferimit të krediteve në institucione të tjera të larta arsimore, i unifikimit të moduleve apo lëndëve mësimore, si dhe i bashkëpunimit me institucionet e larta arsimore brenda e jashtë vendit.
- Fitimi prej studentëve i elementëve të parë dhe shprehive të punës kërkimore studimore si objektiv i posaçëm i studimeve akademike, në auditor e jashtë tij, nëpërmjet detyrave praktike si: punimi i eseve akademike, diskutimi dhe zgjidhja e “kazu”-ve të ndryshëm, realizimi i projekteve kërkimore-studimore, detyrave të kursit e deri te punimi i diplomës.
- Gjatë vitit të parë akademik t’u ofrojë studentëve njohuri të përgjithshme të mbështetura në lëndë të formimit bazë të karakterit sociologjik, psikologjik, juridik, etj. Ndërkohë, gjatë viteve të tjera të studimeve akademike, të realizohet thellimi në njohuritë që përkojnë me profilin e diplomës për siguri dhe hetim, duke vendosur objektiva specifike për përgatitjen e specialistëve të aftë për të operuar në këtë fushë.
- Është pjesë e objektivave të këtij programi dhe kurrikulës t’u ofrojë studentëve njohuritë e nevojshme për të zgjidhur problematikat profesionale me të cilat do të përballen gjatë ushtrimit të detyrave dhe profesionit të tyre, duke përmbushur kështu në kohë nevojat që do t’u lindin atyre (punonjësve të policisë) për kualifikim të mëtejshëm dhe ecuri në karrierë, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Me shlyerjen e detyrimeve të parashikuara, në përfundim të këtij programi studentët do të zotërojnë kapacitetet analitike dhe konceptet e nevojshme për të trajtuar problematikat teorike dhe praktike të fushës së sigurisë dhe hetimit, duke siguruar në këtë mënyrë njohuritë e nevojshme akademike për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit.

8. Struktura dhe karakteristikat e “Programit të studimeve”

a. *Struktura*. “Programi i studimeve “Bachelor” për “Sigurinë dhe Hetimin”, është program studimesh universitare i ciklit të parë, i organizuara në module dhe i vlerësuara në kreditë, sipas “Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve” (ECTS).

Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese janë të organizuara në 5 kategori lëndësh, nga A-ja deri tek E-ja. Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, D dhe E, janë lëndë të detyrueshme, ndërsa lëndët e kategorisë C janë lëndët ndërdisiplinore/integruese dhe lëndët me zgjedhje.

Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program (por edhe kreditet për secilën prej tyre) mund të rishikohen nga departamentet dhe “Dekanati”, duke i dërguar për miratim në Senatin Akademik.

Gjatë vitit të fundit të studimeve, studenti përgatit një punim, temë diplome, për të cilën edhe vlerësohet nga një komision i ngritur Fakulteti. Disiplinat mësimore, veprimtaritë dhe detyrimet akademike vlerësohen me kreditë ECTS.

b. *Veprimtaritë formuese*. Ndër veprimtaritë formuese që karakterizojnë “Programin e studimit “Bachelor” për Sigurinë dhe Hetimin “ përmendim:

- mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë);
- studimi individual (hulumtimi, kërkimi, studimi, punim relacionesh, detyrat apo projektet, përgatitjet e provimeve, përgatitja e tezës së diplomës, etj);
- veprimtari të tjera të lidhura ngushtësisht me aspekte profesionale, si praktika në strukturat e policive vendore, strukturat e procedimit, si dhe vendosja në rol;

Përcaktimi dhe ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë përcaktohet nga personeli akademik në departamentet përgjegjëse, në bazë të krediteve që i janë caktuar asaj disipline.

c. *Disa karakteristika*. “Programi i studimeve “Bachelor” për “Sigurinë dhe hetimin”, ka karakteristika dalluese në raport me të tjerët, si:

- është program me kohë të plotë, me një kohëzgjatje normale tre vjeçare dhe në fund të tij mund të fitohen 180 kreditë;
- procesi mësimor është i organizuar në vite akademike;
- studenti që ndjek studimet me kohë të plotë, fiton deri 60 kreditë në vit;
- viti akademik zgjat 30-32 javë mësimore, i ndarë në dy semestra;
- semestri akademik zgjat 15-16 javë mësimore;
- java mësimore është pesë ditë (e hënë - e premte);
- çdo ditë mund të zhvillohen deri në 5 orë mësimi;
- studenti zhvillon jo më shumë se 25 orë mësimore/javë, në auditor;
- koha e fillimit, koha e mbarimit, sesionet e provimeve, pushimet e dimrit dhe të festave zyrtare, etj, përcaktohen në kalendarin akademik, i cili miratohet çdo vit.

Bazë për hartimin e plankalendarit mësimor akademik janë udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Arsimit Rinisë dhe Sporteve dhe “Senatit Akademik” të Akademisë.


d. *Ndarja e krediteve sipas kategorisë se lëndëve*. Në tërësinë e krediteve që do të marrë studenti që ndjek këtë program studimi, për tu diplomuar të ketë fituar:

- 32 kreditë (ECTS), për kategorinë A të lëndëve bazë; përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme;

- 89 kreditë (ECTS), për kategorinë B të lëndëve karakterizuese; përgatitje për disiplinën shkencore.
- 26 kreditë (ECTS), për kategorinë C të lëndëve ndërdisiplinore/integruese; nëndisiplina, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje;
- 27 kreditë (ECTS), për kategorinë D lëndë plotësuese; gjuhë e huaj, njohuri informatike, praktika profesionale;
- 6 kreditë (ECTS), për kategorinë E detyrime përmbyllëse punimin e diplomës.

Numri i përgjithshëm i lëndëve ose grup-lëndëve të programit së bashku me praktikën mësimore dhe punimin e diplomës janë 22 në 3 vite akademike. Provimet e studentëve organizohen sipas moduleve .

Ndarja e krediteve sipas kategorisë së lëndëve



9. Kompetencat që fitohen nga realizimi i objektivave

Nga zhvillimi i disiplinave dhe veprimtarive akademike që përshkruhen në programin e studimeve për sigurinë dhe hetimin, do të mundësohet realizimi i objektivave të formimit tërësor të studentëve dhe do të fitohen dije, aftësi e shprehi profesionale që do të përbejnë profilin kulturor e profesional të studentit:

- Realizimi i dijeve për kategorinë A të lëndëve bazë; përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme, çka do të vijë nga zhvillimi i një grupi disiplinash dhe veprimtarive formuese nga fusha e psikologjisë, sociologjisë, drejtësisë, lëndë të veçanta, etj. Realizimi i këtij objektiv do të rrisë kapacitetet e studentëve për analizë dhe sintezë, për organizim dhe planifikim, njohuritë themelore të përgjithshme dhe mbështetjen për njohuritë bazë të profesionit.
- Përftimi dhe përvetësimi i dijeve për kategorinë B të lëndëve karakterizuese; përgatitje për disiplinën shkencore të karakterit të formimit të posaçëm ç'ka lidhet me përkatësinë dhe të veçantën që përcjell program i studimit që realizohet me anë të këtyre disiplinave.
- Marrja e njohurive dhe dijeve për kategorinë C të lëndëve ndërdisiplinore/integruese; nëndisiplina, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje; të cilat zgjerojnë formimin ndërdisiplinor me anë të veprimtarive dhe disiplinave të ngjashme, të afërta dhe integruese si dhe të lëndëve me zgjedhje me disiplinat dhe veprimtaritë profesionale. Në këtë mënyrë shtohen aftësitë për gjykime kritike dhe arsytime të drejta rreth veprimeve të kryera e vendimeve të marra, aftësi për të punuar në ekip, aftësi ndërpersonale, për të komunikuar me ekspertë të fushave të tjera, vlerësim të zgjidhjeve alternative dhe respektimit të mendimit ndryshe.
- Nëpërmjet disiplinave për kategorinë D lëndë plotësuese; gjuhë e huaj, njohuri informatike, praktika profesionale; të përftohen aftësitë njohëse e prezantuese, ose të aftësive komunikuese që lehtësojnë kryerjen e detyrave të përbashkëta me partnerët e

huaj. Kështu shtohen aftësitë e komunikimit me gojë e shkrim, njohjet për një gjuhë të huaj, aftësi për menaxhim e informatikë, vlerësim të larmisë shumë-kulturore, aftësi për të bashkëpunuar në kontekst apo me partnerë ndërkombëtarë, aftësi për të zgjidhur problemet dhe për vendimmarrje, etj.

10. Profili i diplomës “Specialist për Sigurinë dhe Hetimin”

“Programi i studimeve për “Sigurinë dhe Hetimin”, synon të japë njohuri bazë mbi format, metodat dhe parimet e përgjithshme të menaxhimit policor, aftësi specifike për menaxhimin e tërësisë së shërbimeve dhe specialiteteve që përfshihen në Policinë e Shtetit, si dhe në institucionet e tjera ligjzbatuese.

Me shlyerjen e të gjitha detyrimeve dhe realizimit të 180 krediteve, pasi ka shlyer edhe detyrimet e provimit të mbrojtjes së diplomës, studenti përfundon me sukses ciklin e parë të studimeve “Bachelor” për “Siguri dhe Hetim”, me kohë të plotë.

Ai pajiset me Diplomën “Specialist për Sigurinë dhe Hetimin”, e cila është dokument zyrtar dhe përmban të dhënat e sakta të studentit. Kjo “Diplomë”, shoqërohet me “suplementin e diplomës”- dokument ky që hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës evropiane të arsimit të lartë.

Në suplement përshkruhen në veçanti, natyra, niveli, përmbajtja, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfundimi me sukses i të gjitha detyrimeve akademike e administrative nga mbajtësi i diplomës. Përmbajtja dhe forma e diplomës si dhe përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës janë të përcaktuara në “Statutin e Akademisë së Sigurisë”, “Rregulloren e Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit” sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit Rinisë dhe Sportit.

11. Programi i formimit të përgjithshëm dhe juridik (universitar)

Në tërësinë e planit mësimor, lëndët e formimit të përgjithshëm ose të formimit universitar, përbëjnë 8 disiplina mësimore ku zënë 17.8 % të orëve dhe krediteve të “Programit të studimeve “Bachelor” për Sigurinë dhe Hetimin”. Më konkretisht, lista e lëndëve të këtij karakteri është:

Lëndët bazë; përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme:

1. E drejtë Kushtetuese
2. Histori e Shtetit dhe së Drejtës në Shqipëri
3. Shkrim Akademik
4. E drejta Administrative
5. Psikologji dhe Komunikim
6. Sociologji konflikti
7. Psikologji Ligjore (e krimit)
8. Mjekësi ligjore

Nëpërmjet këtyre disiplinave të këtij programi synohet që, studenti të përfitojë e zotërojë dije e njohuri të nivelit bashkëkohor në fushë të shkencave shoqërore të; komunikimit, psikologjisë, në fushën juridike të formimit të përgjithshëm. Të gjitha këto për të mbikëqyrur e zbatuar më korrektesë ligjin, për sigurimin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë ushtrimit të kompetencave për

sigurinë dhe hetimin dhe në veçanti zbatimin e detyrave procedurale me atributet e oficerit të policisë gjyqësore.

Me mbarimin e studimeve të këtij programi, te studenti do të evidentohet një profesionist në fushën e policisë me:

- nivel të lartë kulturor, njohuri të plota shoqërore, kushtetuese e juridike, për ushtrimin e kompetencave dhe attributeve që ju ngarkon ligji;
- një sistem i qëndrueshëm vlerash morale dhe cilësish të personalitetit e të karakterit;
- aftësi për të menaxhuar stresin, ekuilibrat psikologjikë, komunikimin me qytetarët dhe drejtimin e burimeve njerëzore;
- aftësi për të analizuar dukuritë dhe problemet e ndryshme psikosociale;
- aftësi profesionale për të punuar në grup dhe për të zbatuar procedurat e teknikat ligjore dhe profesionale sipas etikës policore;
- perceptime të drejta mbi botën, jetën e përditshme dhe profesionin, përmes njohurive teoriko-praktike më ndikim direkt ose indirekt në profesionin e tyre të ardhshëm.

12. Programi i lëndëve karakterizuese; përgatitje për disiplinën shkencore.

Lëndët e formimit karakterizues ose profesional, në “Planin mësimor”, përbëhen nga 13 disiplina mësimore ose 51,9% të numrit të përgjithshëm të lëndëve dhe krediteve që përmban “Programi i studimeve “Bachelor” për “Sigurinë dhe Hetimin”. Ngarkesa mësimore e shprehur në orë për lëndët profesionale është 2325 orë, ose rreth 51.9% e totalit të orëve mësimore, të gjithë ciklit trevjeçar të studimeve, e më konkretisht:

Lëndët dhe modulet e “Formimit profesional”

1. Njohuri për armët e zjarrit dhe qitje
2. Përgatitje fizike-vetëmbrojtje,
3. Administrim dokumentacioni
4. Veprimtaria gjurmuese/Metodat Speciale të Hetimit
5. Rrjeti informativ
6. Menaxhimi i Shërbimeve të Policisë
7. Informacioni dhe Analiza
8. Hetimi i Krimit
9. Procedimi Policor
10. Teknikat dhe Taktikat e Pyetjes
11. Menaxhimi dhe kontrolli i kufirit
12. Menaxhim i Trafikut Rrugor
13. Kriminalistike.
14. Praktikë Profesionale.

Qëllimi kryesor i këtij grupi lëndësh është të përgatisë specialistin e ardhshëm të policisë me njohuri profesionale bashkëkohore dhe aftësi vepruese, për të gjitha shërbimet e policisë, të fushës parandaluese dhe të mbikëqyrjes së territorit; për mënyrat e marrjes, administrimit dhe trajtimit të informacionit; për inteligjencën, investigimin, sigurinë dhe hetimin e krimeve; për zotërimin e teknikave dhe shprehive vetëmbrojtëse, e deri te aftësitë organizative e menaxheriale për postet apo funksionet e rolit që do të luajnë në strukturat policore.

Me shlyerjen e provimeve të lëndëve dhe përfundimin e detyrimeve të këtij programi, studentët, do fitojnë njohuri e aftësi të plota:

- mbi organizimin, misionin dhe detyrat institucionale të Policisë së Shtetit dhe sistemin bazë që rregullon veprimtarinë e saj;
- për aktet ligjore dhe nënligjore që ngarkojnë me detyra, të drejta dhe attribute policinë, me koncepte e shprehi profesionale mbi policimin demokratik;
- për shërbimet që organizon dhe taktikat që duhet të përdorë për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të veta;
- mbi veprimet konkrete për të zgjidhur konfliktet dhe realizuar shërbime parandaluese, si dhe për masat e veprimet procedurale në raste ngjarjesh të veçanta;
- në fushën e hetimit të krimeve, synohet që studenti të zotërojë njohuri teorike e praktike mbi mjetet e metodat shkencore dhe teknikat speciale investigative të policisë, të autorizuara nga ligji procedural penal;
- mbi parimet dhe taktikat e operimit informativ/ gjurmues dhe mënyrat e marrjes e të trajtimit të informacionit kriminal;
- njohuri të plota në fushën e shërbimeve policore, për legjislacionin që rregullon veprimtarinë e tyre, për të drejtat dhe përgjegjësitë, për teknikat e ndërhyrjes, kontrollit, vetëmbrojtjes etj.;
- aftësitë e shprehite aplikative për realizimin e misionit dhe detyrave të shërbimit policor;
- aftësitë për ekzekutime të ligjshme me kompetencë e paanshmëri gjatë detyrës;
- dije profesionale për parandalimin dhe zbulimin e kriminalitetit dhe aftësi për ushtrimin me kompetencë të detyrave të oficerit të policisë gjyqësore;
- njohës, zotërues e përdorues i metodave e teknikave bashkëkohore në luftën kundër krimin të organizuar, trafikëve të ndryshme, terrorizmit etj.;
- aftësitë menaxhuese e drejtuese për shërbimet ekzekutive ndaj kontrollit të territorit, kufirit, qarkullimin rrugor, shërbimeve të emergjencës, ndihmës së parë për qytetarët etj.;
- aftësi abstraguese e analitike për dukuritë kriminale dhe cenimet e rendit, shprehite për veprimtari studimore e kërkimore të pavarur në fushat e policisë dhe strukturave të tjera ligjzbatuese, etj.

13. Programi i lëndëve ndërdisiplinore/integruese; nëndisiplina, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje;

Lëndët ndërdisiplinore/integruese; nëndisiplina, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje, në “Planin mësimor”, përbëhen nga 6 disiplina mësimore ose rreth 14.4% të numrit të përgjithshëm të krediteve që përmban programi i studimit. më kretisht:

1. E drejta Penale (Pjesa e Përgjithshme)
2. E drejta Penale (Pjesa e Posaçme)
3. E Drejta Procedurale Penale
4. Informatikë. Barazia gjinore dhe ligji
5. Sociologji Konflikti. Krimet kompjuterike
6. Elemente të së drejtës publike. Kriminologji

Me realizimin e lëndëve të mësipërme, studentët, do fitojnë njohuri e aftësi të plota për:

- formim juridiko-penal për kryerjen e detyrave në fushën e rendit dhe të sigurisë publike.
- për ushtrimin me kompetence të veprimeve procedurale në fushën e hetimit të krimin;
- nxitjen e aftësive individuale të studentëve duke u krijuar mundësinë e zgjedhjes, atje ku ata mendojnë se mund të japin më të mirën e tyre.

14. Kërkimi shkencor në veprimtarinë akademike

Parashikimi i detyrimeve për kërkimin dhe studimet shkencore është ndër parimet universale të zhvillimit të arsimit në institucionet akademike publike. Për rrjedhojë, arsimi policor, si

pjesë e arsimit të lartë publik, me anë të këtij programi studimesh synon të sigurojë “integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor”.

Ky aspekt i detyrimeve akademike të studentëve, gjen shprehjen e vet në rregulloren e “Programit të studimeve” dhe në programet e lëndëve. Në terma më konkrete, secili student duhet të përgatisë të paktën një punim akademik me temë të përcaktuar nga pedagogu ose me temë të lirë, individualisht apo në grup; studentët të hulumtojnë mbi raste të përgjithësuara nga praktika kombëtare e ndërkombëtare policore. Ata do të vihen në rolin e përfaqësuesit të policisë, në situata imituese që organizohen në auditor apo jashtë tij.

Ilustrimi i çështjeve teorike, me raste të shumta nga praktika e shërbimeve policore, do të bëjë që studenti të kuptojë thellësisht problemet e trajtuara, të bëjë analiza dhe të nxjerrë përfundime rreth tyre. Nëpërmjet vështrimit të problemeve nga të gjithë aspektet, tek studenti nxitet prirja për analizë e sintezë, për të përdorur vëzhgimin, anketimin, intervistimin, krahasimin, studimin e rasteve të veçanta, si metoda të kërkimit shkencor, për të arritur pse jo edhe të mendimi kritik dhe nxjerrja e përfundimeve.

Njohuritë dhe dijet për punën kërkimore si dhe shprehitë apo elementët e parë të veprimtarisë studimore e hulumtuese, si objektivi i posaçëm i studimeve akademike, studentët do t'i fitojnë nëpërmjet:

- shpjegimeve teorike në auditor, diskutimeve kritike rreth projekteve të realizuara dhe përmes formave të tjera didaktike;
- projekteve të vogla kërkimore e hulumtuese dhe detyrave praktike jashtë klasës;
- diskutimit dhe zgjidhjes së kazuseve të ndryshëm;
- punimit të “Eseve akademike”;
- projekteve, punimeve apo detyrave të kursit;
- përfshirjes në grupet e punës së aktiviteteve shkencore të departamenteve;
- pjesëmarrjes në projekte studimore të përmasave të Fakultetit apo Akademisë;
- realizimit të detyrimit të programit “Bachelor”, “Punimi apo tema e diplomës”.

14. Praktika Profesionale

Në programet e lëndëve si dhe në këtë plan mësimor, është parashikuar një periudhë kohore prej tetë javësh për praktike profesionale e ndarë kjo në dy pjesë. Në plan kalendar, dy javë të praktikës profesionale do të zhvillohen nën vëzhgimin e pedagogëve në përfundim të semestrit të katërt (semestri i dytë i vitit të dytë) ndërsa pjesa tjetër e praktikës profesionale do të përkohë më kohën e përgatitjes së punimit të diplomës dhe do të shtrihet në dy muajt e fundit, të semestrit të dytë, të vitit të tretë, njëkohësisht janë rritur orët e praktikës edhe gjatë semestrave të tjerë duke i dhënë programit gjithmonë e më tepër karakter praktik.

Synimi kryesor i këtij programi, është vënia në rol e studentëve në të gjitha shërbimet që kryejnë strukturat policore vendore, dhe strukturave të tjera ligjzbatuese, me qëllim aftësimin e tyre në veprimtarinë praktike, për kryerjen e detyrave sipas rolit që do të kryejnë.

Me fillimin e vitit të fundit akademik, departamentet ju bëjnë me dije studentëve programin e praktikës, drejtuesit e grupeve të përzgjedhur nga stafi mësimdhënës për drejtimin e praktikës, vendet e planifikuara për zhvillimin e saj, si dhe kohën e kryerjes së tij. Studenti që nuk realizon programin e praktikës shpallet jokalues (mbetës) kërkesë kjo si për gjithë detyrimet e tjera akademike.

Gjatë kryerjes së praktikës, pedagogu që e drejton atë, ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje më strukturën ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës, studenti përgatit një raport për punën e kryer, e cila vlerësohet nga pedagogu që e drejton praktikën. Për praktikën e zhvilluar krijohet një dosje, ku evidentohet ecuria e studentit në të gjitha fazat e praktikës. Strukturat ku zhvillohet praktika japin mendim me shkrim për vlerësimin e studentit, të cilat i bashkëngjiten dosjes së studentit. Komisioni i vlerësimit pasi studion dosjen për të dy fazat e praktikës bën vlerësimin me një notë përfundimtare. Komisioni i ngritur ka përfaqësues nga departamenti i Hetimit, Rendit dhe Sigurisë dhe ai i Formimit të Përgjithshëm dhe Juridik.

Për zhvillimin sa më normal dhe sa më eficient të praktikës nga Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, hartohet një plan i veçantë në bashkëpunim me AS-në dhe Drejtorinë e Përgjithshme të PSH, dhe strukturave të tjera ligjzbatuese, në të cilin përcaktohen qartë të gjitha detyrimet e studentëve, komisariateve ku do të kryhet praktika dhe stafit akademik që do të ndjekë zhvillimin e praktikës.

15. Provimi i diplomës

Për të fituar diplomën e studimeve “Bachelor” për “Sigurinë dhe Hetimin”, studentët që ndjekin këtë program, përveç arritjes së rezultateve pozitive të kursit dhe kryerjes së praktikës, duhet t’i nënshtrohen edhe provimit final, pjesë e të cilit është përgatitja dhe paraqitja para një komisioni të punimit të diplomës.

Punimi i diplomës është një punë kërkimore e cila realizohet në mënyrë individuale dhe të pavarur, për një çështje a problem nga fusha e sigurisë, hetimit dhe paraqitet për mbrojtje pas përfundimit të detyrimeve të programit.

Punimi synon të demonstrojë aftësitë studimore, kërkimore e analitike të studentit, aftësitë e tij për të integruar njohuritë teorike me materiale të ndryshme empirike, për të shprehur një qëndrim të caktuar profesional për çështje të policimit. Rregullat që ndiqen për punën me temat e diplomës, modalitetet e realizimit, kriteret e vlerësimit etj., normohen në rregulloren e “Programit të studimeve të ciklit të parë *Bachelor*”.

Pjesa II

PLANI MËSIMOR I STUDIMEVE PËR

SIGURINË DHE HETIMIN

Hyrje

Plani mësimor i “Programit të studimeve “Bachelor”, të Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit” në Akademinë e Sigurisë”, është një ndër dokumentet themelore të këtij programi. Ai përfshin tërësinë e veprimtarive formuese (leksioneve, seminareve, praktikave, etj.) që ky fakultet ofron për kryerjen e studimeve dhe marrjen e diplomës së specialistit të lartë për “Sigurinë dhe Hetimin” në Policinë Shtetit. Në këtë “Plan mësimor” përfshihen:

- lëndët e formimit bazë,
- lëndët karakterizuese,
- lëndët ndërdisiplinore/integruese,
- lëndët plotësuese dhe praktika mësimore profesionale,
- detyrimet përmbyllëse.

Të gjitha këto disiplina e veprimtari janë vlerësuar të nevojshme për plotësimin e procesit akademik formues të specialistit dhe menaxherit të Policisë së Shtetit. Plani mësimor, është dokument me karakter të gjerë informativ, por edhe normativ, të detyrueshëm për zbatim pas miratimit të tij.

Ky plan mësimor është produkt i një veprimtarie të gjerë studimore e konsultative me grupe të ndryshme interesi, brenda e jashtë policisë, me specialistë të policimit, si dhe me studiues të rendit, hetimit, sigurisë, kriminologjisë, sociologjisë e jurisprudencës. Si rrjedhojë e gjithë këtyre, u përftua një listë e plotë lëndësh mësimore, u përcaktuan prioritetet dhe kërkesat që burojnë e lidhen me eksperiencat më të mira të shkollës sonë të policisë dhe me standardet e pritshmëritë e publikut për performancë më të lartë policore.

Lëndët dhe modulet e parashikuara për formimin e përgjithshëm e të posaçëm të studentëve, për detyrat që do kryejnë dhe përgjegjësitë që do të përmbushin gjatë ushtrimit të detyrës, e bëjnë planin dhe gjithë procesin mësimor të orientuar drejt profesionalizmit dhe aplikimit praktik të shprehive dhe njohurive të fituara.

Gjatë hartimit të disiplinave mësimore u bë kujdes që të pasqyroheshin qartë kërkesat e udhëzimit Nr. 41 datë 24.01.2018 të MARS, me qëllim që formimi teorik të krijojë dhe mbështetet në ekuilibrat e nevojshëm midis disiplinave të formimit të përgjithshëm dhe atij profesional, duke i dhënë përparësi këtij të fundit, ku të dyja së bashku A+B nuk duhet të jetë më pak se 70%, aktualisht ato zënë rreth 70%. Po kështu janë pasur parasysh edhe raportet e drejta ndërmjet disiplinave social-psikologjike dhe atyre juridiko-administrative e të organizimit, dhe, i gjithë programi të vendosë theksin e duhur të formimit shoqëror e juridik aq edhe të përvetësimit dhe zbatimi i procedurave ligjore dhe respektimi i parimeve të shtetit ligjor e të drejtave të njeriut.

Metodat kryesore të punës mësimore në Fakultetin e Sigurisë dhe të Hetimit, përcaktuar këto dhe në statutin dhe rregulloren e “Programit të studimeve “Bachelor””, janë: leksionet, seminarët, ushtrimet në klasë, stërvitjet e grupuara, mësimet në laboratorë, praktikat

mësimore, vizitat dhe praktikat profesionale në strukturat e policisë, prokurorisë, kontrollet me shkrim dhe me gojë, detyrat dhe projektet e kursit, provimet e lëndëve, projektet kërkimore, tema e diplomës, etj. Zbatimi me korrektesë i Plan/Programit mësimor nga trupa akademike, do të mund të realizohen objektivat dhe qëllimet e këtij plani mësimor dhe programit të studimit.

1. Detyrat themelore të “Planit mësimor”

Qëllimet dhe detyra themelore e planit dhe programit mësimor janë të përgatisë:

a. specialistë të lartë policie për Sigurinë dhe Hetimin, të aftë për të shërbyer në strukturat e Policisë së Shtetit, në të gjitha funksionet operuese e menaxheriale;

b. specialistë me kulturë e dije të nivelit universitar, (psikologjike, sociale, juridike e profesionale), standarde të larta etike profesionale dhe njohës të mirë të ligjit, të misionit dhe përgjegjësi institucionale të policisë;

c. specialistë me aftësi praktike e shprehje aplikative në zotërimin e teknikave bashkëkohore të fushës së parandalimit e luftës kundër krimit dhe për menaxhimin e situatave të rendit, hetimit e sigurisë.

2. Emërtimi i “Programit të studimit”


Programi i studimit, pjesë e të cilit është edhe ky Plan mësimor, emërtohet Studime të ciklit të parë “Bachelor” për “Sigurinë dhe Hetimin”. Këto studime organizohen dhe realizohen në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, pranë Akademisë së Sigurisë; në përmbushje të detyrave të tyre për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit të nivelit operues, administrativ dhe menaxherial, në të tre ciklet e studimeve universitare.

Ndër synimet kryesore të programit të studimeve për sigurinë dhe hetimin janë: ofrimi i njohurive të përgjithshme kulturore, juridike, sociologjike, psikologjike, etj. Dhe thellimi në njohuritë që përkohjnë me profilin e diplomës për “Siguri dhe Hetim”, për përgatitjen e specialistëve të rendit, sigurisë e luftës ndaj krimit, të aftë për të operuar në fushën e hetimit të krimit; si dhe përmbushja e nevojave që ka policia për specialistë të aftë profesionalisht për të zgjidhur problematika profesionale me të cilat do të përballen gjatë ushtrimit të detyrave dhe goditjen e formave e metodave të krimit të organizuar.

3. Kohëzgjatja dhe struktura e studimeve

a) Studimet “Bachelor” për “Sigurinë dhe Hetimin”, janë studime universitare me kohë të plotë dhe realizohen me një kohëzgjatje normale në 3 (tre) vite akademike. Për çdo vit akademik, studenti ndjek rregullisht studimet dhe fiton 60 kreditë. Në përfundim të studimeve trevjeçare studenti fiton 180 kreditë (ECTS).

b) Procesi mësimor është i organizuar në vite akademike, me dy semestra për çdo vit studimesh (gjashtë semestra për tre vjet), me tre sezone provimesh në vit, me një periudhë prej tetë javësh praktike profesionale, me dy periudha dyjavore, një në vit të parë dhe tjetra në vitin e dytë, stërvitje e grupuara mbi bazë kursi, etj.



c) Viti akademik zgjat 30-32 javë mësimore, i ndarë në dy semestra; semestri akademik zgjat 15 – 16 javë mësimore; java mësimore është pesë ditë (e hënë – e premte); çdo ditë mund të zhvillohen deri në 5 orë mësimi; studenti zhvillon jo më shumë se 25 orë mësimore/javë, në auditor⁶.

Koha e fillimit të vitit mësimor, e mbarimit, sesionet e provimeve, pushimet ndërmjetëse akademike dhe festave zyrtare, etj. Përcaktohen në plan-kalendarin akademik, i cili del çdo fillim viti akademik⁷. Bazë për hartimin e plan kalendarit mësimor akademik janë udhëzimet përkatëse të ministrit të Arsimit dhe Senatit Akademik të Akademisë së Sigurisë.

4. Procedurat, burimet dhe referencat e “Planit mësimor”

Si dokumente referuese apo burimore në të cilat u mbështet hartimi i planit janë përcaktimet dhe referencat ligjore të Arsimit të Lartë (ligji dhe aktet nënligjore e normative) eksperiencat pozitive dhe përvojat më të mira të shkollimit tonë policor, standardet e shkollave policore perëndimore, etj.

Nga veprimtaritë më kryesore të ndërmarra gjatë fazës së hartimit e të plan-programit mësimor, veçojmë: konsultat me personelin mësimdhënës e administrativ të “Kolegjit të Lartë Policor”⁸, tryezat për bashkëbisedim dhe shkëmbime mendimesh me specialistët, pedagogët dhe drejtuesit e Akademisë së Sigurisë dhe marrja e mendimeve të specialistëve të strukturave operuese dhe realizimi i ballafaqimeve e konsultave me ekspertët e drejtorisë së Kufirit & Migracionit, të Rendit, Sigurisë Publike e Investigimit të Krimeve.

Gjatë kontakteve me grupet e interesit dhe faktorët institucionale, departamentet i kushtuan kujdes të veçantë marrjes së vlerësimeve, mendimeve, opinioneve dhe sugjerimeve të tyre, për disa nga çështjet më thelbësore si:

- në cilat aspekte mendohet se duhet përmirësuar puna akademike për lartësimin e profilit të specialistit të rendit, sigurisë, hetimit dhe luftës ndaj krimit;
- drejtimit ku duhet të thellohet veprimtaria e arsimit të lartë profesional për të evituar hendekun midis teorisë dhe praktikës dhe rritjen e shkallës së integritimit mes tyre;

⁶ Udhëzimi Nr. 15 datë 04.04.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të Arsimit të Lartë”

⁷ Ky plan kalendar hartohet mbas Urdhrit të dalë nga Ministria e Arsimit për këtë qëllim.

⁸ Kjo strukturë arsimore përgatit student të nivelit bazë policor të cilët mbas dy vjetësh punë janë kandidaturat për student në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit.

- a është e mjaftueshme përgatitja për t'u përballur me format e reja të kriminalitetit dhe tendencat e zhvillimeve në fushën e rendit dhe krimit;
- programi mësimor aktual përcjell kulturën qytetare, dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të ketë specialisti i policisë;
- çfarë duhet të përmirësojmë që specialisti i policisë të përfaqësojë ekspertin e çështjeve të rendit e sigurisë, hetimit, parandalimit të krimit e konflikteve dhe policimit për komunitetin;

5. Veprimtaritë formuese (disiplinat) që përbëjnë “Planin mësimor”

Lista me lëndët mësimore të “Programit të studimit për Sigurinë dhe Hetimin “dhe konkretisht të këtij “Plani mësimor” përbëhet nga dy grupe kryesore lëndësh:

- lëndë të formimit bazik apo të përgjithshëm dhe
- lëndë të formimit karakteristik ose profesional.

Duke analizuar në detaje, dallohen lëndë të formimit juridik, psikologjik e social, të formimit policor, inteligjent, të formimit fiziko-taktik, mjeshtërinë e përdorimit të armëve të zjarrit, etj., të cilat, jo vetëm që rrisin nivelin në realizimin e profilit kulturor, juridik e profesional të specialistit të ardhshëm, por rrisin edhe atë të vetë planit mësimor. Efektivisht është parashikuar që të zhvillohen këto lëndë e module:

2. STRUKTURA E PLANIT MËSIMOR “PËR SIGURINË DHE HETIMIN“ Lista e disiplinave të “Planit mësimor”

Nr	Lëndët dhe Modulet mësimore	Kat.	ECT S	Leks.	Sem.	D. Kur Prak	Ng. Mesi	Përg. Individ	Total
01	E drejta Kushtetuese	A	4	30	15	3	48	52	100
02	E drejta Administrative,	A	4	30	15	3	48	52	100
03	Kriminalistike	A	6	25	20	30	75	75	150
	Hyrje në ekonomi	A	4	30	15	3	48	52	100
04	1.E Drejta Penale (Pj. Përgjithshme)	C	5	30	15	15	60	65	125
	2.E Drejta Penale (Pj. Posaçme)	C	6	35	15	22	72	78	150
05	E Drejta Procedurale Penale	C	6	35	15	22	72	78	150
06	1.2.Psikologji Komunikim	A	4	30	15	3	48	52	100
	2.Psikologji ligjore (e krimit)	A	4	30	15	3	48	52	100
	3.Mjekësi Ligjore	A	4	15	15	18	48	52	100
07	Te drejtat e njeriut	D	4	30	15	3	48	52	100
08	Sistemet Informatike Policor (SIP)	D	3	15	15	6	36	39	75
09	E Drejta Civile	D	4	30	15	3	48	52	100
10	Gjuhë e huaj	E	5	30	30	0	60	65	125
11	1.Shkrim Akademik	A	4	15	15	18	48	52	100
	2.Histori shteti të se drejtës në Shqipëri	A	4	30	15	3	48	52	100
12	Informacioni dhe Analiza	B	4	30	15	3	48	52	100
13	Vep. Gjurmuese / Metodat speciale të hetimit	B	8	45	25	25	95	105	200
14	1.Rrjeti informative	B	4	30	15	0	45	55	100
	2.Procedimi Policor	B	5	30	15	15	60	65	125
15	Teknikat dhe Taktikat e Pyetjes	B	5	30	15	15	60	65	125
16	Krimi i Organizuar dhe Terrorizmi	B	6	30	25	15	70	80	150
17	Hetimi i Krimit Ekonomik, Korrupsionit.	B	5	30	15	15	60	65	125
18	Hetimi i krimeve kundër pers. E pronës.	B	5	30	15	15	60	65	125
19	1.Njohuri për armët dhe qitje	B	5	24	12	19	57	68	125
	2.Përgatitje Fizike-Vetëmbrojtje	B	8	0	0	102	102	98	200
20	Administrim dokumentacion	B	4	30	15	12	57	43	100
21	1.Menaxhimi i Shërbimeve të Policisë	B	7	45	30	30	105	70	175
	2.Ruajtja e PLSH-ve	B	3	15	15	6	36	39	75

22	Menaxhimi dhe kontrolli i kufirit	B	7	30	30	18	78	97	175
23	Menaxhim Trafikut Sigurisë rrugore	B	7	30	30	18	78	97	175
24	1. Barazia gjinore e Ligji/ Informatikë	C	3	15	15	5	35	40	75
	2. Sociologji Konflikti/ Kriminologji	C	3	15	15	5	35	40	75
	3. Krimet kompjuterike/Elementë të Drejtës Publik	C	3	15	15	5	35	40	75
25	Praktikë Profesionale 1.	D	4	0	0	70	70	30	100
	Praktikë Profesionale 2.	D	7	0	0	150	150	25	175
26	Diploma/mikroteza	E	6	0	0	10	10	140	150
TOTAL (për 3 vite)			180	914	577	708	2199	2301	4500

6.1. Veprimtaritë formuese të planit sipas kategorive, orëve dhe moduleve

Veprimtaritë formuese dhe lëndët apo disiplina të që përbëjnë planin mësimor, rrjedhimisht dhe programin e studimit, në tërësinë e tyre gjykohen të grupuara fillimisht sipas përkatësisë apo fushës (lëndët e formimit të përgjithshëm dhe lëndët e formimit profesional), brenda këtyre grupimeve ndarja sipas karakterit (në lëndë të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje), dhe mandej, projeksionet për module të ndryshme

NDARJA E LËNDËVE SIPAS VEPRIMTARIVE FORMUESE

3. “Lëndë bazë” Kategoria A

Nr	Lëndë e module mësimore	ECTS	Orët mësimore				St. Individ.	Total
			Leks.	Sem.	D. Kur Prak.	Ng. Mes		
1.	E drejta Kushtetuese	4	30	15	3	48	52	100
2.	Histori e shtetit të se drejtës	4	30	15	3	48	52	100
3.	Shkrim Akademik	4	15	15	18	48	52	100
4.	E drejta Administrative,	4	30	15	3	48	52	100
5.	Psikologji Komunikim	4	30	15	3	48	52	100
6.	Hyrje në ekonomi	4	30	15	3	48	52	100
7.	Psikologji ligjore (e krimin)	4	30	15	3	48	52	100
8.	Mjekësi Ligjore	4	15	15	18	48	52	100
	Total	32	210	120	54	384	416	800

4. “Lëndë karakterizuese” Kategoria B

Nr	Lëndë e module mësimore	ECTS	Orët mësimore				St. Individ.	Total
			Leks	Sem.	D. Kur Prak.	Ng. Mes		
1.	1. Njohuri për armët dhe qitje	5	24	12	19	55	70	125
	2. Përgatitje fizike –vetëmbrojtje	8	0	0	102	102	98	200
2.	Administrim Dokumentacioni	4	30	15	12	57	43	100
3.	Vep gjurmuese/Metodat spec. të hetimit	8	45	25	25	95	105	200
4.	Informacioni dhe Analiza	4	30	15	3	48	52	100
5.	1. Rrjeti informativ	4	30	15	0	45	55	100
	2. Procedimi Policor	5	30	15	15	60	65	125
6.	1. Menaxhimi i Shërbimeve të Policisë	7	45	30	30	105	70	175
	2. Ruajtja e PLSH-ve	3	15	15	6	36	39	75
7.	Teknikat dhe Taktikat e Pyetjes	5	30	15	15	60	65	125
8.	Krimi i Organizuar dhe Terrorizmi	6	30	25	15	70	80	150
9.	Hetimi i krimin Ekonomik e Korrupsionit	5	30	15	15	60	65	125

10.	Hetimi i krimeve kundër personit e pronës.	5	30	15	15	60	65	125
11	Menaxhimi dhe kontrolli i kufirit	7	30	30	18	78	97	175
12	Menaxhim Trafikut Sigurisë rugore	7	30	30	18	78	97	175
13	Kriminalistike	6	25	20	30	75	75	150
14	Praktikë Profesionale 1.	4	0	0	70	70	30	100
	Total	93	454	292	408	1014	1171	2325

3. “Lëndë ndërdisiplinore/integruese” Kategoria C

Nr	Lëndë e module mësimore	ECTS	Orët mësimore				St. Individ.	Total
			Leks.	Sem	D. Kur Prak.	Ng. mes		
1.	E Drejta Penale (Pj.Përgjithshme)	5	30	15	15	60	65	125
2.	E Drejta Penale (Pj. Posaçme)	6	35	15	22	72	78	150
3.	E Drejta Procedurale Penale	6	35	15	22	72	78	150
4.	1. Barazia gjinore dhe Ligji 2. Informatikë	3	15	15	5	35	40	75
5.	1. Sociologji konflikti 2. Kriminologji	3	15	15	5	35	40	75
6.	1. Krimet kompjuterike 2. Elementë të së Drejtës Publike	3 3	15 15	15 7	5 15	35 37	40 38	75 75
	Total	26	145	90	74	309	341	650

4. “Lëndë plotësuese” Kategoria D

Nr	Lëndë e module mësimore	ECTS	Orët mësimore				St. Individ.	Total
			Leks.	Sem	D. Kur Prak.	Ng. mes		
1.	Gjuhë e huaj	5	30	30	0	60	65	125
2.	Te drejtat e njeriut	4	30	15	3	48	52	100
3.	E Drejta Civile	4	30	15	3	48	52	100
4.	Sistemet Informatike Policore (SIP)	3	15	15	6	36	39	75
5.	Praktikë Profesionale 2.	7	0	0	150	150	25	175
	Total	23	105	75	162	342	233	575

5. “Detyrime përmblyëse” Kategoria E

Nr	Lëndë e module mësimore	ECTS	Orët mësimore				St. Individ.	Total
			Leks.	Sem.	D. Kur Prak.	Ng. mes		
1.	Provimi Diplome	6	0	0	10	10	140	150
	Total	6	0	0	10	10	140	150
Shuma e përgjithshme e lëndëve sipas kategorive								
Lëndë e module mësimore: gjithsej 32		180	914	568	687	2169	2331	4500

6.2. Modulet e lëndëve të Formimit bazë dhe ndërdisiplinor

“Formimi Psikologjik dhe sociologjik”

- Psikologji dhe Komunikim
- Psikologji ligjore (e krimit)
- Sociologji konflikti

“Formimi Juridik”

- E Drejta Kushtetuese
- Histori e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri
- Elementë të së Drejtës Publike
- Kriminalistikë
- **“Disiplina të formimit Penal”**
- E Drejta Penale (Pjesa e Përgjithshme)
- E Drejta Penale (Pjesa e Posaçme)
- E Drejta Procedurale Penale
- **“Disiplina Komunikimi”**
- Gjuha e Huaj
- Sistemet informatike
- **“Formim i përgjithshëm”**
- Hyrje në ekonomi
- Shkrimi Akademik

6.3. Modulet e lëndëve karakterizuese

- **“Formim Institucional”**
- Legjislacion Policor
- Administrimi i informacionit policor
- **“Menaxhimi i Sigurisë Publike”**
- Menaxhimi i shërbimeve policore
- Krimi i Organizuar
- **“Hetim krimi”**
- Rrjeti informativ
- Hetim i krimit ekonomik dhe korrupsioni.
- Teknikat dhe taktikat e pyetjes.
- Veprimtari gjurmuese dhe metodatat speciale të hetimit
- **“Shërbimi Policisë Rrugore”**
- Legjislacioni rrugor
- Menaxhimi i trafikut
- **“Kufiri dhe Migracioni”**
- Menaxhimi dhe Kontrolli i Kufirit
- Menaxhimi i rreziqeve
- **“Aftësimi tekniko-taktik, AZ dhe qitje”**
- Përgatitje fizike dhe teknika vetëmbrojtje
- Njohuri për armët e zjarrit dhe qitje
- Ruajtja e PLSH-ve

6.4. PLANI MËSIMOR SIPAS VITEVE, SEMESTRAVE, ETJ

Tërësia e lëndëve mësimore dhe aktiviteteve përbërëse të tyre, do të mund të realizojnë qëllimin e planit dhe objektivat formuese të vetë programit të studimeve, nëse bazohen në një plan kalendarik të studiuar dhe vendosen të renditura sipas kohës që do të zhvillohen (vitet e studimit dhe semestrat korrespondues), sipas krediteve për çdo veprimtari formuese, të ndara në leksione, seminare, punë praktike, detyra, projekte, etj., por dhe nëse ka përcaktime të qarta të ngarkesës në auditor dhe ngarkesës (studimit individual) jashtë auditorit, etj.

Vendosja e lëndëve mësimore është bërë dhe mbi bazën e një logjike të dhënies së informacionit studentëve, informacion ky i përshkallëzuar deri në fund të procesit mësimor.

PLANI MESIMOR

VITI I PARË										
Semestri i parë										
Nr	Lëndët	Kat.	ECTS	Lek.	Sem	D.Kur Prakt.	Ng. Mes	Përg. Indiv	Total	Prov im
1	E drejta Kushtetuese	A	4	30	15	3	48	52	100	+
2	Histori e shtetit të së drejtës	A	4	30	15	3	48	52	100	+
3	Gjuhë e huaj	D	2.5	15	15	0	30	32.5	62.5	+
4	Shkrim Akademik	A	4	15	15	18	48	52	100	+
5	Njohuri për armët dhe qitje	B	5	24	12	19	55	70	125	+
6	Te drejt. e njeriut	D	4	30	15	3	48	52	100	+
7	Psikologji Komunikim	A	4	30	15	3	48	52	100	+
8	Përgatitje fizike -vetëmbrojtje	B	2	0	0	30	30	20	50	-
Totali semestri i II-të			29.5	174	102	79	355	382.5	737.5	
Semestri i dytë										
1	Gjuhë e huaj	D	2.5	15	15	0	30	32.5	62.5	+
2	Hyrje në ekonomi	A	4	30	15	3	48	52	100	-
3	E Drejta Penale (Pj.Përgjithshme)	C	5	30	15	15	60	65	125	
4	Administrim Dokumentacioni	B	4	30	15	12	57	43	100	+
5	E Drejta Civile	D	4	30	15	3	48	52	100	+
6	Përgatitje fizike-vetëmbrojtje	B	2	0	0	24	24	26	50	-
7	Psikologji ligjore (e krimit)	A	4	30	15	3	48	52	100	+
8	Lende me zgjedhje : 1. Barazia gjinore dhe Ligji, 2. Informatikë	C	3	15	15	5	35	40	75	+
Totali semestri i II-të			28.5	180	105	65	350	362.5	712.5	
Totali I vitit të parë			58	354	207	144	705	745	1450	
VITI I DYTE										
Semestri i tretë										
1	E Drejta Penale (Pj.Posaçme)	C	6	35	15	22	72	78	150	+
2	Rrjeti informativ	B	4	30	15	0	45	55	100	+
3	Menaxhimi i Shërbimeve të Policisë	B	3	15	15	6	36	39	75	-
4	Informacioni dhe Analiza	B	4	30	15	3	48	52	100	+
5	Veprimtaria gjurmuese/Metodat speciale të hetimit.	B	4	25	15	1	41	59	100	-
6	E drejta Administrative,	A	4	30	15	3	48	52	100	-
7	Lëndë me zgjedhje: 1; Krimet kompjuterike 2.Elemente të Drejtës Publike	C	3	15	15	5	35	40	75	+
8	Përgatitje Fizike-Vetëmbrojtje	B	2	0	0	24	24	26	50	-
Totali i semestrit të III-të			30	180	105	64	349	401	750	
Semestri i katërt										
1	Veprimtaria gjurmuese/Metodat speciale të hetimit.	B	4	20	10	24	54	46	100	+
2	Procedimi Policor	B	5	30	15	15	60	65	125	+
3	Menaxhimi i shërbimeve të policisë	B	4	30	15	24	69	31	100	+
4	E Drejta Procedurale Penale	C	6	35	15	22	72	78	150	+
5	Përgatitje Fizike-Vetëmbrojtje	B	2	0	0	24	24	26	50	-
5	Lëndë me zgjedhje: 1. Sociologji konflikti 2. Kriminologji	C	3	15	15	5	35	40	75	+
6	Praktikë Profesionale 1.	B	4	0	0	70	70	30	100	
Totali i semestrit të IV-të.			28	130	70	184	384	316	700	
Totali i vitit të II-të.			58	310	175	248	733	717	1450	

VITI I TRETË										
Semestri i pestë										
1	Teknikat dhe Taktikat e Pyetjes	B	5	30	15	15	60	65	125	+
2	Hetimi i krimeve kundër personit e pronës.	B	5	30	15	15	60	65	125	+
3	Kriminalistike	B	3	15	15	6	36	39	75	-
4	Menaxhimi dhe kontrolli i kufirit	B	3	15	15	6	36	39	75	-
5	Menaxhim Trafikut Sigurisë rugore	B	4	15	15	12	42	58	100	-
6	Sistemet Informatike Policor (SIP)	D	3	15	15	6	36	39	75	+
7	Mjekësi Ligjore	A	4	15	15	18	48	52	100	+
8	Ruajtja e PLSH-ve	B	3	15	15	6	36	39	75	-
Totali i semestrit të V-të			30	150	120	84	354	396	750	
Semestri i gjashtë										
1	Menaxhim dhe kontrolli i kufirit	B	4	15	15	12	42	58	100	+
2	Menaxhim Trafikut Sigurisë rugore	B	3	15	15	6	36	39	75	+
3	Kriminalistike	B	3	10	5	24	39	36	75	+
4	Hetimi i Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit.	B	5	30	15	15	60	65	125	+
5	Krimi i Organizuar dhe Terrorizmi	B	6	30	25	15	70	80	150	+
6	Praktikë Profesionale 2.	D	7	0	0	150	150	25	175	
	Diploma	E	6	0	0	10	10	140	150	
Totali i semestrit të VI-të			34	100	75	232	407	443	850	
Totali i vitit të III-të			64	250	195	316	761	839	1600	
TOTALI I TRE VITEVE			180	914	577	708	2199	2301	4500	

7. Vështrim analitik i raporteve teori-praktikë në “Planin mësimor”

7.1. **Përkatësia e lëndëve.** Po të bëjmë një vështrim të përgjithshëm analitik e krahasues mbi planin mësimor, lëndët me karakter formues, raportet teori-praktikë, ndarjen e orëve dhe krediteve, konstatojmë se:

- në grupin “Profesionale”, të kategorisë “B” janë 13 lëndë plus praktikë 1 e cila zhvillohet në interes të lëndëve profesionale, me një ngarkesë mësimore 2325 orë konvertuar këto në 93 kreditë ECTS. Ky grup lëndësh në planin e përgjithshëm mësimor së bashku me praktikën mbulon 51.6 % të orëve të programit;
- Lëndët e grupit bazë dhe ato karakterizuese, A+B përbëjnë 125 kredite ose rreth 70% të orëve të përgjithshme të planit mesimor.
- 19 lëndë në planin mësimor i përkasin “Formimit bazë, ndërdisiplinor dhe plotësues” të kategorizuara këto në grupet “A”, “C”, “D”. Këto lëndë mbulojnë 2025 orë mësimore konvertuar këto në 81 kreditë ECTS, dhe zënë rreth 45.1 % të orëve mësimore.
- Përgatitja e diplomës dhe praktikës mesimore janë vlerësuar me nga 6 kredite.

7.2. **Raporti teori-praktikë (orë leksioni me orë seminari, punë praktike, etj.)** Studimi i raporteve midis orëve të lëndëve të formimit profesional dhe orëve të lëndëve të “Formimit bazë, të përgjithshme” është në raport 51.6 % me 45.1 % në favor të lëndëve karakterizuese.

Po ashtu, nga vështrimi i tërësisë së veprimtarive dhe disiplinave formuese të planit mësimor (4500 orë mësimore), veçanërisht për raportin midis mësimoreve teorike (leksioneve) dhe seminareve, punës praktike dhe kontrollit të dijeve në auditor, do të evidentojmë këto raporte si më poshtë:

- 2199 orë, afërsisht 48.8% e totalit, janë orë mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime, etj.); Prej tyre, 914 orë, ose rreth 20.3 % janë leksione dhe rreth 1285 orë, ose rreth 28.5% janë seminare, ushtrime e punë praktike;
- brenda zërit mësimi praktike, seminarët janë 717 orë dhe zënë rreth 55.8% të tyre dhe orët e punëve apo mësimi praktike janë 588 ose 44.2%;
- pjesa tjetër, rreth 2301 orë, ose 51.13 % e gjithë orëve të studimeve, është studim individual i pavarur dhe ka të bëjë kryesisht me studimin e literaturës së rekomanduar, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, etj. Sqarojmë se, në këtë grup orësh, përfshihen dhe veprimtari të tilla si praktika profesionale apo stazhi pranë strukturave vendore e rajonale të policisë dhe përgatitja e tezës së diplomës.

7.3. *Impakti pozitiv në formimin e studentëve.* Nga ballafaqimi i shifrave të sipërpërmendura, raportet në përqindje rreth 49 dhe 51%, (të kohës në auditor dhe studimit individual), i gjejmë me vend e të rregullt. Shkuarja, pothuajse deri te barazimi i orëve të mësimi në auditor dhe studimit të pavarur apo individual, do të bëjë që, te studenti të kultivohet e rritet përgjegjshmëria personale, ndjenja për të punuar në mënyrë të pavarur, për t'u përshtatur me situatat dhe për të zbatuar njohuritë në praktikë. Sikurse do të krijohen e zhvillohen tek ai aftësitë organizative të planifikimit e kontrollit, do të rritet iniciativa dhe fryma sipërmarrëse, aftësitë e komunikimit e bashkëpunimit me ekspertë të fushave të tjera, të vlerësimit të zgjidhjeve alternative dhe respektimit të mendimit ndryshe, etj.

8. Standardet e personelit akademik të “Programit të studimit”

Personeli akademik i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, i cili do të realizojë “Programin e studimeve “Bachelor” për “Sigurinë dhe Hetimin”, përbëhet nga :

- personeli akademik,
- personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe
- personeli administrativ.

Detyrat dhe të drejtat e tyre përcaktohen në legjislacionin për Arsimin e Lartë dhe aktet ligjore e nënligjore në zbatim të tij, në legjislacionin për Policinë e Shtetit, në statutin e Akademisë së Sigurisë dhe në Rregulloret e Brendshme të Akademisë së sigurisë dhe Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit. Sikurse në të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë, ata kategorizohet sipas rolit dhe veprimtarisë që kryejnë në procesin mësimor duke u klasifikuar në: “profesorë, docentë dhe lektorë”.

Për rekrutimin e personelit akademik të Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të cilat kushtëzohen nga vetë departamenti ku do të punojë dhe lënda që do të zhvillojë.

Si kategori e veçantë, personeli akademik i “Departamentit të Hetimit të Krimit; Departamenti i Rendit dhe Sigurisë; Departamenti i Trajnimit të Vazhdueshëm” kandidati duhet të plotësojë disa kritere të veçanta :

- të ketë mbaruar studimet me kohë të plotë në Akademinë e Policisë;
- të ketë kryer minimalisht studimet e nivelit “Master” për lëndët që do të japë në auditor;
- të ketë notën mesatare mbi 8 dhe notën 9 ose 10 të lëndëve që do të jetë pedagog;
- të ketë mbi 10 vjet shërbim policor dhe të ketë fituar gradën kryekomisar / drejtues.
- Kriteret për Personel Akademik të brendshëm dhe të ftuar janë përcaktuar në Rregulloren e e këtij fakulteti.

Personeli akademik duhet të kryejë veprimtari të mësimdhënies, kërkim shkencor, shërbime për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të institucionit, konsultim dhe këshillim për studentët, si dhe detyra administrative. Raportet ndërmjet tyre dhe veprimtarive të ndryshme përcaktohen në rregulloret e departamenteve, në rregulloren e fakultetit, në statut dhe janë pjesë e kontratave të punës mes palëve.

